



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
KËSHILLI BASHKIAK

Pukë, më 26.04.2024

Nr.862/4 prot:

VENDIM

Nr 16 date 23.04.2024

PËR:

**“Për dhënie në përdorim me afat 10 vjet, sipërfaqen pyjore prej 10ha, për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore, turistike, sportive dhe kulturore”.ne parcelen Nr.138,139/b ekonomia pyjore Gomsiqe.**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ndryshuar në 9, pika 1.2 , germa a dhe c, nenin 27 pika 5, nenin 54 germa e/1, nenin 55 pika 3.Ligjit Nr. 57/2020 .Për Pyjet, Vendim.Nr.559, Datë 29.7.2022 Për Përcaktimin E Çmimeve Dhe Tarifave Për Dhënien Në Shfrytëzim/Përdorim Të Fondit Pyjor Kombëtar, Për Veprimtari Ekonomike, Si Dhe Për Prodhimet Drusore Dhe Jo drusore Pyjore, Vendim nr. 433, datë 8.6.2016 Për Transferimin Në Pronësi Të Bashkive Të Pyjeve Dhe Të Kullotave Publike, Sipas Listave Të Inventarit, Dhe Aktualisht Në Administrim Të Ministrisë Së Mjedisit e Të Ish-Komunave/Bashkive( Per Bashkine Puke Shtojca nr 48). Udhezim Nr. 01.09.2016 “Per Rregullat, Procedurate Kerkimit, te shqyrtimit e Miratimit te Kerkesave Per dhenien ne Perdorim te Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik”.

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim të sipërfaqes prej 10 ha “ për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore, turistike, sportive dhe kulturore” sipas Ligjit Nr. 57/2020 Per pyjet, konkretisht Neni 25 – “Përfitimet nga shfrytëzimi për veprimtari ekonomike në fondin pyjor kombëtar 1. Pjesë të fondit pyjor public jepen në shfrytëzim/perdorimi për zhvillimin e veprimtari vepër: a) qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore, turistike, sportive dhe kulturore”. Ky propozim bëhet për në ngastren nr. 138,139/b të ekonomise pyjore Gomsiqe, sipas plan rilevimit, relacionit dhe studimit tekniko-ekonomik bashkelidhur.
2. Afati i dhenies me qira propozohet të jetë 10 vjet.
3. Vlera e dhenies me qira do të perlllogaritet sipas Vendim Nr. 559, Datë 29.7.2022 Për Përcaktimin E Çmimeve Dhe Tarifave Për Dhënien Në Shfrytëzim/Përdorim Të Fondit Pyjor Kombëtar, Për Veprimtari Ekonomike, Si Dhe Për Prodhimet Drusore Dhe Jo drusore Pyjore).
4. Pas miratimit te ketij projekt –vendimi ngarkohet per ndjekje dhe zbatim Drejtoria Menaxhimit te Pyjeve e Kullotave dhe Bujqesise.

5. Shpallur me datë 26.04.2024

6. Miratuar me 9 vota; Vota Pro 9 , Vota Kundër 0, Vota Abstenim 0

**SEKRETARE**

Edona **HYSENAJ**



**KRYETARI I KESHILLI**

Eduard **GJOKA**

